

ZKA: Siguria në shkollë kërkon angazhim të përbashkët të institucioneve | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



PDK-ja DHE ALEANCA DORËZOJNË KALLËZIME PENALE NË PROKURORINË SPECIALE NDAJ QEVERISË NË DETYRË



Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar të mërkurën në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës kallëzim penal ndaj Albin Kurtit dhe

anëtarëve të Qeverisë në dorëheqje, lidhur me ushtrimin e njëkohshëm të funksioneve ekzekutive dhe mandateve të deputetëve. Po ashtu, edhe

Aleanca ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Speciale ndaj Qeverisë në detyrë, për 17 vendime që ka marrë në mbledhjen e 12 gushtit

WIKOFF THOTË SE S'I TAKON KFOR-it TË VENDOSË PËR HAPJEN E URËS MBI IBËR, POR KOSOVËS DHE BE-së | F. 3



UNIVERSITETI I PRISHTINËS U NDAN TITULLIN "DOCTOR HONORIS CAUSA" JOSEPH J. DIOGUARDIT DHE SHIRLEY CLOYES DIOGUARDIT | F. 3



AKTUALE



SHBA-ja PEZULLON TERMINET PËR VIZA PËR APLIKANTËT NË MBARË BOTËN | F. 2

SERWER: ZGJEDHJET E REJA MUND TË MOS SJELLIN ZGJIDHJE PËR KRIZËN NË KOSOVË | F. 5

KONJUFCA: LVV I KA EMRAT, GJASAT JANË TË MËDHA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT | F. 6

EKONOMI



VENDOSËT GURTHEMELI PËR AUTOSTRADËN SHKUP - BLLACË | F. 8

ÇMIMET E IMPORTIT NË KOSOVË RRITEN 1.4% NË TM2, POR BIEN 2.6% NË BAZË VJETORE | F. 8

SPORT



KOSOVA HUMB NGA ITALIA DHE ELIMINOHET NGA PADELI NË LOJËRAT MESDHETARE | F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja PEZULLON TERMINET PËR VIZA PËR APLIKANTËT NË MBARË BOTËN

UASHINGTON, 26 GUSHT - Administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, ka pezulluar terminet për viza për aplikantët në mbarë botën. Vendimi është pjesë e një fushate të vazhdueshme të Qeverisë amerikane për ashpërsimin e politikave të emigracionit gjatë mandatit të dytë të udhëheqësit republikan në Shtëpinë e Bardhë. Një zëdhënës i Departamentit amerikan të Shtetit tha se ka nisur një iniciativë për trajnimin e stafit në të gjitha ambasadat dhe konsullatat amerikane në mbarë botën dhe se terminet për shërbimet e vizave do të përshtaten për t'iu mundësuar

punonjësve pjesëmarrjen në trajnim. Trump ka ndjekur një politikë për dëbimin e emigrantëve dhe ashpërsimin e politikave të emigracionit, e cila përfshin revokimin e vizave dhe vizës së njohur si Green Card, si dhe refuzimin e aplikimeve për një sërë arsesh, përfshirë qëndrimet politike dhe protestat propalestineze kundër fushatës ushtarake të Izraelit, aleatit të SHBA-së, në Gazë. Ai argumenton se kjo fushatë synon përmirësimin e sigurisë së brendshme. Megjithatë, masat e ndërmarra nga administrata amerikane janë përballur me



disa pengesa ligjore. Ditë më parë, një gjykatë në SHBA rrëzoi një vendim të administratës Trump që pezullonte lëshimin e vizave për migrantët nga 75 shtete – përfshirë nga Kosova – duke thënë se një politikë e tillë përbënte tejkalim të kompetencave ligjore të

sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio. Departamenti i Shtetit nuk dha detaje për trajnimin që do të realizojë apo edhe afatet se kur do të mbahet, vetëm tha se ky trajnim synon t'i ndihmojë zyrtarët konsullorë të përjashtojnë aplikantët që vlerësohet se mund të bëhen të varur nga përfitimet publike në SHBA, si dhe të sigurojë që vlerësimi i aplikantëve për viza të bëhet “në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të njëtrajtshme”. Pezullimi i termineve për viza u raportua fillimisht nga Financial Times, që tha se aplikantët për

viza imigruese që kishin intervista të caktuara në ambasadat dhe konsullatat amerikane kishin pranuar email-e ku njoftoheshin se takimet e tyre po riplanifikoheshin dhe se do të njoftoheshin më vonë për një datë të re. Trump gjatë fushatës presidenciale për mandatin e dytë në Shtëpinë e Bardhë premtoi se do të dëbonte miliona migrantë pa dokumente dhe administrata e tij ka ndërmarrë një sërë veprimesh që kur ai u kthye në Shtëpinë e Bardhë, masa që synojnë përsheptimin e dëbimeve dhe uljen e numrit të kalimeve të paligjshme kufitare.

VIZITA E SHEFIT TË CIA-S NË MOSKË NGRE PYETJE PËR RUSINË, UKRAINËN DHE IRANIN

UASHINGTON, 26 GUSHT - Drejtori i Agjencisë Qendrore amerikane të Inteligjencës (CIA), John Ratcliffe, zhvilloi një vizitë të paparalajmëruar në Moskë më 25 gusht, konfirmuan për Radion Evropë e Lirë zyrtarë amerikanë. Kjo vizitë e rrallë vjen në një kohë kur përpjekjet e Uashingtonit për t'i dhënë fund luftës së Rusisë kundër Ukrainës kanë ngecur dhe tensionet lidhur me marrëdhëniet e Moskës me Iranin janë përshkallëzuar. Arsyja e vizitës së Ratcliffe, e para që publikisht dihet se ka realizuar në Rusi që kur ai u bë drejtor i CIA-s gjatë mandatit të Donald Trump, nuk ishte menjëherë e qartë. Zyrtarë amerikanë, që ishin në dijeni të udhëtimit, konfirmuan se ai fluturoi drejt Moskës, por nuk pranuan të zbulonin përmbajtjen e takimeve të tij apo të tregonin me kë u takua.

CIA dhe Shtëpia e Bardhë nuk u deklaruan për media.

Vizita, e raportuar fillimisht nga CBS News, u sinjalizua nga të dhënat e gjurmimit të fluturimeve, të cilat tregonin një avion transporti ushtarak amerikan duke udhëtuar nga Shtetet e Bashkuara përmes Letonisë drejt Moskës. Avioni, që dukej se ishte nisur nga Baza Andrews në Merilend, ateroi në Aeroportin Vnukovo të Moskës më 25 gusht dhe u largua nga Rusia më vonë po atë ditë, sipas të dhënave të gjurmimit të fluturimeve. Kjo ngriti pyetje se pse kreu i agjencisë amerikane të inteligjencës po vizitonte Rusinë në një moment kaq delikat. Vizita e fundit në Moskë e një drejtori të CIA-s, që dihet publikisht, ishte ajo e paraardhësit të Ratcliffe, William Burns, i cili u takua me presidentin rus, Vladimir Putin, në nëntor 2021, tre muaj para se Putini të niste pushtimin në

shkallë të plotë të Ukrainës. Natyra e këtij udhëtimi sugjeron se reziaku ishte i lartë, tha për REL-in Glen Howard, ekspert për Rusinë dhe kryetar i Saratoga Foundation, një institut me bazë në Shtetet e Bashkuara. “Drejtorët e CIA-s nuk shkojnë në Moskë nëse nuk duan të kërkojnë diçka”, tha Howard, duke shtuar se ata nuk “udhëtojnë deri në Rusi nëse nuk është diçka e rëndësishme”. “Burns shkoi atje në nëntor 2021, para pushtimit rus, për t'i paralajmëruar [rusët] që të mos pushtonin Ukrainën”, tha ai. Zyrtarë të lartë të inteligjencës amerikane kanë mbajtur kontakte me homologët e tyre rusë gjatë luftës, por takimet ballë për ballë në këtë nivel mbeten të rralla.

Karota dhe shkopinj?

Një shpjegim i mundshëm është Ukraina, veçanërisht përpjekja e administratës amerikane për të përcaktuar nëse Moska mund të bindet ende të negociojë për t'i dhënë fund luftës. Përpjekjet e ndërmjetësuar nga SHBA-ja kanë ngecur, pavarësisht takimit të Trumpit me Putinin në Alaskë në gusht të vitit 2025. “Do të shpresoja që në krye të listës së tij të ishte një kërkesë e drejtpërdrejtë që Putin t'i japë fund kësaj lufte të pajustificuar të agresionit kundër Ukrainës”, tha për REL-in Bradley Bowman, drejtor i lartë i Qendrës për Fuqinë Ushtarake dhe Politike në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive, me bazë në Uashington. Bowman, ish-këshilltar për sigurinë kombëtare i anëtarëve të Komiteteve të Senatit amerikan për Forcat e Armatosura dhe Marrëdhëniet me Jashtë, tha se Uashingtoni duhet ta bëjë të qartë se dështimi për t'i dhënë fund luftës do të sjellë masa gjithnjë e më të dhimbshme kundër Rusisë, ndërsa SHBA-ja dhe aleatët e saj vazhdojnë ta ndihmojnë



Ukrainën të mbrohet. Bowman përmendi edhe një tjetër temë të mundshme: mbështetjen e Rusisë për Iranin.

Rusia dhe Irani

“Shpresoj që ai të ketë thënë gjithashtu se Putin duhet të ndalojë së ofruari ndihmë për Iranin për lëshimin e satelitëve”, tha Bowman, duke shtuar se Moska duhet të ndalojë gjithashtu ofrimin e mbështetjes që mund ta ndihmojë Iranin të godasë forcat amerikane, përfshirë informacionet për shënjestrimin, ndihmën lidhur me dronët dhe kapacitete të tjera ushtarake. Rusia ka lidhje të mëdha ushtarake dhe tregtare me Iranin. Vizita e Ratcliffe erdhi një ditë pasi sekretari amerikan i Thesarit, Scott Bessent, njoftoi një përpjekje të re për të “ndërprerë çdo burim ekonomik që mban gjallë këtë regjim tiranik derisa Teherani të mbetet i vetëm” dhe tha se vendeve do t'u jepen afate për të “mbyllur” aktivitetet që e mbështesin atë. Howard gjithashtu sugjeroi se Irani mund të jetë në qendër të misionit të Ratcliffe, megjithëse theksoi se ky ishte spekulimi i tij dhe jo një fakt i konfirmuar. Sipas tij, Ratcliffe mund të jetë duke u përpjekur ta bindë Moskën të ndalojë furnizimin ose ndihmën për Iranin, duke e kthyer potencialisht vizitën në një paralajmërim jashtëzakonisht të drejtpërdrejtë për Kremlinin.

Bowman iu referua raportimeve se Rusia i ka ofruar Iranit informacione për shënjestrimin dhe i ka transferuar taktika dhe teknika të përdorimit të dronëve të zhvilluara gjatë luftës në Ukrainë. Ai argumentoi se mbështetja e Moskës mund të jetë një nga arsyet pse Irani ka qenë në gjendje të ruajë qëndrueshmërinë ushtarake dhe t'i rezistojë presionit për të negociuar.

Një vizitë e rrallë në një moment të ndjeshëm

Vizita e Ratcliffe në Moskë ishte e veçantë edhe për shkak të reputacionit të tij si një kritik i ashpër i Rusisë. Howard iu referua mbështetjes së mëparshme të Ratcliffe për mbajtjen e këshilltarëve të CIA-s në Ukrainë për të ndihmuar me inteligjencën dhe shënjestrimin, edhe pse Pentagoni po lëvizte drejt zvogëlimit të pranisë së tij këshilluese atje. Kjo, argumentoi Howard, sugjeron se Ratcliffe ka një linjë veçanërisht të drejtpërdrejtë me Trumpin. Ndërkohë, Moska e ka akuzuar Shtetet e Bashkuara se po ofrojnë mbështetje të fortë për sulmet ukrainase ndaj Rusisë. Pa paraqitur prova, ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, tha në fillim të këtij muaji se Rusia i kishte dërguar Departamentit të Shtetit pyetje “lidhur me çështjen e të dhënave të inteligjencës dhe faktin se SHBA-ja është shumë më

e përfshirë në organizimin dhe realizimin e sulmeve në thellësi të territorit rus”.

Amerikanët pas hekurave

Disa vëzhgues spekuluan se fati i amerikanëve të burgosur ose të ndaluar në Rusi mund të ketë qenë pjesë e qëllimit të vizitës. CIA ka luajtur një rol të rëndësishëm në përpjekjet e mëparshme për të siguruar lirinë dhe kthimin e amerikanëve të burgosur, përfshirë shkëmbimin e vitit 2024 që mundësoi lirinë e gazetarit të Wall Street Journal, Evan Gershkovich, gazetares së REL-it, Alsu Kurmasheva, dhe ish-marinsit amerikan Paul Whelan. Ratcliffe gjithashtu luajti rol në negociatat që çuan në lirinë e Ksenia Karelina, shtetase ruso-amerikane e cila kaloi më shumë se një vit burgim në Rusi pasi autoritetet ruse e akuzuan për mbështetje ndaj Ukrainës. “Ekziston një përgjegjësi serioze për çdo zyrtar të Qeverisë amerikane që flet me cilindo shtet që po mban padrejtësisht një shtetas amerikan, që ta ngrejë këtë çështje në çdo mundësi”, tha Bowman. Një pyetje që mbetet pa përgjigje është nëse vizita e Ratcliffe përfaqëson përshkallëzim të tensioneve, një hapje diplomatike apo përdorimin e një kanali të inteligjencës për një marrëveshje specifike. Uashingtoni po bën presion për t'i dhënë fund luftës së Rusisë kundër Ukrainës, por Putini - ndonëse duket i interesuar ta mbajë SHBA-në të përfshirë në përpjekjet diplomatike - ka refuzuar thirrjet e SHBA-së dhe Kievit për nisjen e bisedimeve duke i ngrirë vijat e frontit në gjendjen aktuale. Në vend të kësaj, ai këmbëngul që Ukraina t'ia dorëzojë territorin që forcat e Moskës nuk kanë qenë në gjendje ta pushtojnë në fushëbetejë.

WIKOFF THOTË SE S'I TAKON KFOR-it TË VENDOSË PËR HAPJEN E URËS MBI IBËR, POR KOSOVËS DHE BE-së



PRISHTINË, 25 GUSHT - Misioni i NATO-s në Kosovë nuk ka mandat për të vendosur nëse ura kryesore mbi lumin Ibër - që lidh Mitrovicën e Jugut të banuar me shumicë shqiptare, dhe atë të Veriut të banuar me shumicë serbe - duhet të hapet plotësisht, tha të martën admiral amerikan i aleancës, George Wikoff. Wikoff, komandant i Komandës së Forcave të Përbashkëta të NATO-s në Napoli, tha se për këtë duhet të vendosë vetë Kosova dhe Bashkimi Evropian (BE), pasi KFOR-i ta përfundojë praninë e tij të përhershme në urë. “Vendimet lidhur me praninë e KFOR-it në urën e Mitrovicës bazohen në vlerësimin që ne ia bëjmë gjendjes së sigurisë”, tha ai, sipas një komunikate të

KFOR-it. KFOR-i e përsëriti në komunikatë se është duke zhvilluar një proces për kufizimin e pranisë së trupave të saj mbi urën, e cila është e hapur vetëm për këmbësorë, por jo edhe për qarkullimin e automjeteve. Vendimi i misionit paqeruajtës për kufizimin e pranisë dhe kalimin e përgjegjësive mbi urë tek Policia e Kosovës është kundërshtuar nga Serbia. Ura mbi Ibër ishte bllokuar pas luftës së vitit 1999 dhe, ndër vite, ka qenë vatër e përplasjeve etnike. Për këtë arsye, që atëherë misioni paqeruajtës e ka mbajtur nën mbikëqyrje urën. Tani, NATO-ja thotë se tërheqja graduale e trupave nga ura është pjesë e procesit të optimizimit të

pranisë të KFOR-it, pas përmirësimit të gjendjes së sigurisë në vend. KFOR-i shtoi se do të vazhdojë ta vlerësojë rregullisht gjendjen në terren dhe të ruajë një pozicionim të hartuar për të kontribuar në sigurinë e qëndrueshme për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë. Ai theksoi se personeli i saj do të vazhdojë të jetë i pranishëm në zonat përreth urës. Ndërkohë, deklaratat e Wikoffit vijnë disa ditë pasi dështoi një takim i planifikuar mes kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, dhe komandantit të KFOR-it, Ozkan Ulutash. Kurti e paralajmëroi takimin me komandantin Ulutash për të shtunën e kaluar. Por, më vonë

atë ditë, KFOR-i njoftoi se “për shkak të rrethanave të paparashikuara”, takimi mes tyre nuk u zhvillua. Kosova ka kërkuar vazhdimisht viteve të fundit që ura të hapet plotësisht dhe Kurti tha ditë më parë se ishte “absurde” që ura kryesore mbi Ibër vazhdon të jetë e mbyllur. Në anën tjetër, një zëdhënëse e Komisionit Evropian tha javën e kaluar se pret “koordinim efektiv dhe konsultime kuptimplota ndërmjet komunave të prekura dhe institucioneve qendrore të Kosovës” për hapjen e urës. “Ajo që kërkojmë, gjithashtu, është që Policia e Kosovës të garantojë sigurinë e të gjitha komuniteteve, në përputhje me parimet demokratike, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit,

në mënyrë që të gjithë të ndihen të sigurt”, tha zëdhënësjja. Qeveria e Kosovës kishte paralajmëruar në korrik të vitit 2024 hapjen e urës kryesore mbi Ibër edhe për qarkullimin e automjeteve, një nismë që shkaktoi tensione dhe reagime nga bashkësia ndërkombëtare. Ndërkohë ura nuk u hap plotësisht, autoritetet kosovare i ndërtuan edhe dy ura të tjera pranë urës kryesore - një për këmbësorë dhe një për automjete - me synimin për të lidhur Mitrovicën e Veriut me Mitrovicën e Jugut. Serbia i ka kundërshtuar planet e KFOR-it për kufizimin e pranisë mbi këtë urë. Presidenti serb, Aleksandar Vučić, i është drejtuar me një letër shefit të NATO-s, Mark Rutte, duke i kërkuar që ky proces të ndalet. “Sapo i dërgova një letër sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, dhe kërkoja që KFOR-i, në përputhje me Rezolutën 1244 të OKB-së, të ndalë terrorin ndaj serbëve, përndjekjen dhe arrestimet e tyre, rrënimin e shtëpive, si dhe hapjen e urës mbi Ibër”, shkroi Vučić në Instagram më 20 gusht. Sipas Vučićit, tërheqja e KFOR-it nga ura në këtë moment do të “krijonte kushte për një përballje përfundimtare me popullsinë serbe” në veri të Kosovës. Por, ministri në detyrë i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, tha e përpjekjet e Serbisë për ta paraqitur kufizimin e pranisë së KFOR-it si kërcënim për komunitetin serb apo si dëshmi se situata në Kosovë është e paqëndrueshme, nuk përputhen me realitetin në terren.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS U NDAN TITULLIN “DOCTOR HONORIS CAUSA” JOSEPH J. DIOGUARDIT DHE SHIRLEY CLOYES DIOGUARDIT

PRISHTINË, 26 GUSHT - Rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. Arben Hajrullahu, në ceremoninë e ndarjes së titullit “Doctor Honoris Causa” për kongresistin amerikan Joseph J. DioGuardi dhe veprimtaren Shirley Cloyes DioGuardi, ka vlerësuar kontributin e tyre të jashtëzakonshëm për Kosovën dhe shqiptarët. Në fjalën e tij, rektori Hajrullahu tha se Universiteti i Prishtinës sot nuk po nderon vetëm dy personalitete të shquara, por edhe një miqësi dhe një kapitull të rëndësishëm të historisë së përbashkët. “Joseph J. DioGuardi dhe Shirley Cloyes DioGuardi i

kanë dhënë Kosovës shumë më tepër se mbështetje politike: i kanë dhënë zë atëherë kur zëri i saj mezi dëgjohej, i kanë dhënë miqësi atëherë kur ajo kishte shumë nevojë për miq, dhe i kanë dhënë shpresë atëherë kur shpresa ishte ndër gjërat më të rralla”, tha Hajrullahu. Ai theksoi gjithashtu rolin e Ligës Qytetare Shqiptaro-Amerikane në informimin dhe ndërgjegjësimin e opinionit dhe politikës amerikane për çështjen e Kosovës. Sipas tij, një prej rezultateve më të rëndësishme të kësaj pune ishte misioni faktmbledhës i 29 gushtit 1990, kur shtatë senatorë amerikanë,

të udhëhequr nga Robert J. Dole, vizituan Prishtinën. “Ju ishit ndër të parët dhe ndër më këmbëngulësit që trokitët në dyert e politikës amerikane dhe i hapët ato dyert për Kosovën dhe për shqiptarët në përgjithësi”, u shpreh rektori. Hajrullahu rikujtoi edhe sloganin e njohur të DioGuardive: “Pavarësi për Kosovën Tani - E Vetmja Rrugë Drejt Paqes në Ballkan.” Në fund të fjalimit, rektori i Universitetit të Prishtinës u tha dy të nderuarve se dyert e universitetit do t'i kenë gjithmonë të hapura. “Këtu, ashtu si kudo në Kosovë, nuk jeni mysafirë; jeni në shtëpinë tuaj”, përfundoi Hajrullahu.



PDK-ja DHE ALEANCA DORËZOJNË KALLËZIME PENALE NË PROKURORINË SPECIALE NDAJ QEVERISË NË DETYRË

Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar të mërkurën në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës kallëzim penal ndaj Albin Kurtit dhe anëtarëve të Qeverisë në dorëheqje, lidhur me ushtrimin e njëkohshëm të funksioneve ekzekutive dhe mandateve të deputetëve. Po ashtu, edhe Aleanca ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Speciale ndaj Qeverisë në detyrë, për 17 vendime që ka marrë në mbledhjen e 12 gushtit

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Subjekti politik, Aleanca ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Speciale ndaj Qeverisë në detyrë të Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti, për 17 vendime që ka marrë në mbledhjen e 12 gushtit.

Ndërkaq, Partia Demokratike e Kosovës ka dorëzuar kallëzim penal për anëtarët e Qeverisë në detyrë të Kosovës që mbajnë funksione të dyfishta, atë të anëtarit të ekzekutivit dhe të deputetit.

Deputeti i PDK-së, Përparim Gruda tha se duhet intervenimi i Prokurorisë për të mundësuar zbatimin e vendimit të Gjykatës Supreme, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe legjislacionit në fuqi. "Siç dihet ne nuk e kemi të paraparë si vepër penale moszbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por të gjykatave të rregullta siç është Gjykata Supreme. Po ashtu në kallëzim kemi përmendur edhe shpërdorimin e detyrës zyrtare, sepse duke mbajtur funksione të paligjshme janë shpërndarë mijëra euro në disa vendime që janë marrë nga Qeveria e Kosovës dhe kjo situatë nuk mund të vazhdojë", tha Gruda. Sipas dokumentit të datës 26 gusht 2026, PDK-ja vlerëson se

ekziston dyshimi për kryerjen e veprës penale "keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar", si dhe për "mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore", sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës.

Në kallëzim, Albin Kurti cilësohet si i dyshuar së bashku me anëtarët e tjerë të Qeverisë në dorëheqje që janë certifikuar dhe betuar si deputetë të Legjislaturës XI.

Nga 6 korriku 2026 e tutje, të kallëzuarit kanë vazhduar të ushtrojnë njëkohësisht funksionin e anëtarit të Qeverisë dhe mandatin e deputetit, ndonëse, sipas kallëzimit, këto funksione janë të papajtueshme.

Në dokument thuhet se më 12 gusht 2026, të dyshuarit, në cilësinë e personave zyrtarë, kanë mbajtur mbledhjen nr. 32 të Qeverisë dhe kanë nxjerrë 24 vendime.

Në mesin e tyre ka pasur edhe vendime me pasoja të drejtpërdrejta financiare, përfshirë ndarjen e 100 mijë eurove, dhënie me qira të pronës publike me vlerë kontraktore prej 23 mijë e 205 eurosh, inicimin e dy shpronësimeve me kompensim nga buxheti, si dhe emërimin e komisioneve të pranimit për pozita të larta drejtuese.

Me këto veprime janë tejkaluar kompetencat e një Qeverie në

dorëheqje dhe janë shkelur kufizimet kushtetuese dhe ligjore që lidhen me ushtrimin e mandatit të deputetit dhe funksioneve në ekzekutiv. Kallëzimi penal i është adresuar Prokurorisë Speciale, së cilës i kërkohet trajtimi dhe hetimi i pretendimeve të ngritura në dokument.

Kurse sipas dorëzimit të kallëzimit penal të Aleancës në Prokurorinë Speciale ndaj Qeverisë në detyrë të Kosovës, të udhëhequr nga Albin Kurti, për 17 vendime që ka marrë në mbledhjen e 12 gushtit, deputeti Besnik Tahiri ka theksuar se këto vendime janë në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret qeveritare. "Qeveria në detyrë nuk guxon në asnjë moment të shkelë ligjin që vetë e ka miratuar, Ligjin për Qeveri, në ligj të cilin kemi punuar edhe ne për të qenë, për shkak se është ekskluzivisht e thënë në

qartë se kjo qeveri i ka kompetencat dhe detyrime të kufizuara", tha Tahiri në deklarin për media para ndërtesës së Prokurorisë Speciale të Kosovës, në Prishtinë.

Çfarë vendime kishte marrë më 12 gusht Qeveria në detyrë e Kosovës?

Në mbledhjen e 12 gushtit, ekzekutivi në detyrë kishte marrë gjithsej 24 vendime, ndër to ishin qiradhënia e parcelave në Cërnillë të Ferizajt, deri më 18 dhjetor 2033, vendimi për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror, ai për emërimin e komisioneve të pranimit për pozitat e drejtorëve ekzekutivë në Agjencinë Qendrore të Prokurimit, në Thesarin e Kosovës dhe në Agjencinë Kosovare për Standardizim.

Po ashtu disa vendime që lidhen me procedura të shpronësimit dhe prona publike, për themelimin e Komisionit Kombëtar për Refugjatë, vendimi për ndarjen e 100 mijë eurove për DokuFest-in dhe vendime e emërimin të tjera për komisione të pranimit në pozita të larta drejtuese.

Në kallëzimin penal, Aleanca tha se ka përmendur edhe çështjen që, sipas saj, disa deputetë të zgjedhur nga Lëvizja Vetëvendosje po bëjnë shkelje duke vazhduar funksione ekzekutive si ministra. "Nuk mundesh të shkosh paradite në seancë e të betohesh si deputet, të votosh si deputet dhe pastaj prej aty të vazhdosh në Qeveri dhe të ushtrosh detyra ekzekutive si ministër në detyrë".

Kurti, së bashku me disa ministra në detyrë, janë betuar

si deputetë të legjislaturës së 11-të më 6 gusht.

Më 15 korrik 2025 Gjykata Supreme e Kosovës kishte shpallur të të paligjshëm dhe e kishte shfuqizuar një udhëzim administrativ të nxjerrë nga ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati.

Atë kohë kjo gjykatë kishte thënë se nxjerrja e akteve nënligjore apo udhëzimeve administrative nga ministrat që janë deputetë është e kundërligjshme dhe shkel dispozitat kushtetuese, duke nxitur kundërshtim të ashpër nga Qeveria në detyrë. "Qeveria në dorëheqje është e autorizuar të kryejë vetëm aktivitetet e domosdoshme dhe të planifikuara në Planin vjetor të punës së Qeverisë dhe në ligjin vjetor për buxhetin, duke përjashtuar miratimin e akteve nënligjore normative të reja", kishte thënë Supremja.

Sipas Përparim Grudës, moszbatimi i vendimeve gjyqësore përbën vepër penale duke iu referuar këtij vendimi të Gjykatës Supreme. "Moszbatimi i vendimeve gjyqësore i gjykatave të rregullta të Kosovës është vepër penale. Prandaj, moszbatimi i vendimit të Gjykatës Supreme në rastin e Hekuran Muratit, që vlen edhe anëtarët e tjerë të Qeverisë, përbën vepër të pastër penale dhe kërkohet reagimi i shtetit", tha Gruda gjatë një konference për media.

Që nga zgjedhjet e parakohshme të 7 qershorit, ekzekutivi kosovar është në detyrë. Që atëherë, qeveria ka ndërmarrë mbi 70 vendime. Përfaqësuesit e subjekteve të tjera politike, por edhe ata të shoqërisë civile i kanë vlerësuar këto vendime si në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Qeverinë.



SERWER: ZGJEDHJET E REJA MUND TË MOS SJELLIN ZGJIDHJE PËR KRIZËN NË KOSOVË

PRISHTINË, 26 GUSHT - Daniel Serwer, profesor dhe studiues i lartë në Institutin për Politikë të Jashtme të Shkollës së Studimeve të Avancuara Ndërkombëtare të Universitetit Johns Hopkins dhe ekspert i zhvillimeve politike në Ballkan, ka komentuar krizën institucionale në Kosovë, ngërçin në Kuvend dhe mundësinë e zgjedhjeve të reja.

Ai ka deklaruar se zgjidhja e situatës kërkon bashkëpunim ndërmjet partive politike.

I pyetur se kush mban përgjegjësinë kryesore për ngërçin aktual në Kuvendin e Kosovës, Vetëvendosje apo partitë opozitare, Serwer ka thënë se nuk dëshiron të fajësojë asnjërën palë. “Jam më shumë se 3 000 milje larg. Nuk më takon mua të fajësoj askënd. Sistemet parlamentare në shumë vende përballen me probleme të tilla. Kosova nuk është unike në këtë aspekt”, ka deklaruar ai.

Serwer ka vlerësuar se mungesa e një presidenti me kompetenca të plota përbën pengesë serioze për funksionimin e institucioneve të Kosovës.

I pyetur për këmbënguljen e Albin Kurtit që të arrihet një marrëveshje për presidentin



para se Kuvendi të konstituohet plotësisht, Serwer është përgjigjur: “Më duket se mungesa e një presidenti me

kompetenca të plota është, në fakt, një pengesë serioze për institucionet e Kosovës”, ka deklaruar ai.

Sa i përket mundësisë që Kosova të shkojë përsëri në zgjedhje të parakohshme, Serwer nuk e ka përjashtuar

këtë mundësi, por ka shprehur dyshime se një proces i ri zgjedhor do të jetë frytdhënës. “Nuk mendoj se është e porealizueshme, por dyshoj se do të jetë frytdhënës. Presidenti nuk mund të zgjidhet pa bashkëpunim ndërmjet partive. Pikërisht kjo është ajo që nevojitet”, ka deklaruar ai.

Serwer ka deklaruar se përgjegjësia për zgjidhjen e krizës duhet t’u mbetet partive politike të Kosovës.

I pyetur nëse Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian duhet të ndërhyjnë më drejtpërdrejt për të ndihmuar në zgjidhjen e krizës, Serwer ka thënë se preferon që partitë politike ta zgjidhin vetë situatën. “Preferoj që partitë politike të Kosovës të mbajnë përgjegjësinë. Pikërisht për këtë i kanë marrë votat”, ka deklaruar ai.

Ndërkohë, nëse Kuvendi vazhdon të mbetet i bllokuar, Serwer e sheh mundësinë e një tjetër pale zgjedhesh. “Supozoj se do të ketë një tjetër palë zgjedhesh, por ndërkohë Kosova po humb terren në arenën ndërkombëtare. Është koha që t’i kthehemi punës”, ka deklaruar Serwer për “Front Online”.

WALKER U SHKRUAN LIDERËVE POLITIKË, PROPOZON FATON BISLIMIN PËR PRESIDENT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 26 GUSHT - Ish-shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, ambasadori në pension William G. Walker, u është drejtuar me një letër liderëve të partive politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, duke propozuar Faton “Tony” Bislimin si kandidat për president të Kosovës.

Telegrafi ka siguruar letrën e ambasadorit Walker, në të cilën diplomati amerikan shpreh shqetësimin e tij për, siç e cilëson, bllokadën e tejzgjatur të procesit kushtetues për zgjedhjen e presidentit të ri.

Siç merr vesh Telegrafi, letra u është dërguar të gjithë liderëve të partive politike të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës, me kërkesën që emri dhe kualifikimet e Bislimit të merren në konsideratë gjatë diskutimeve për presidentin.

Letra është konfirmuar për Telegrafin, nga persona afër ambasadorit amerikan Walker. “Si mik i Kosovës, jam thellësisht i shqetësuar, ashtu siç jam i bindur se jeni edhe ju dhe qytetarët e Kosovës, për bllokadën e tejzgjatur të procesit kushtetues për zgjedhjen e Presidentit të ri”, thuhet në letrën e Walkerit. “Kam dëgjuar emrat e disa

kandidatëve të mundshëm. Të gjithë meritojnë të merren në konsideratë, por, sipas vlerësimit tim, asnjëri prej tyre nuk i përmbush në tërësi aftësitë, përvojën dhe profilin personal që kërkon posti i presidentit. Prandaj, më lejoni të propozoj një emër. Faton ‘Tony’ Bislimin e njoh prej shumë vitesh. Kemi diskutuar shpesh për politikën e Kosovës, si në planin e brendshëm, ashtu edhe për vendin e këtij shteti të ri në Evropë dhe në botë. Nuk kam asnjë dyshim për pavarësinë e tij në mendim dhe për aftësinë e tij për t’i artikuluar dhe mbrojtur qartë qëndrimet e veta për çfarëdo çështjeje. Sipas mendimit tim, ndër emrat që mund të merren në konsideratë, Fatoni i posedon të gjitha aftësitë e nevojshme, si dhe profilin personal që kërkohet për të qenë një president i suksesshëm”, ka shkruar Walker, duke shtuar se Kosova ka nevojë të madhe për një president që perceptohet si përfaqësues i vendit në tërësi, jo i një partie, i një individi apo i një qëndrimi të ngurtë politik për çdo çështje. “Fatoni nuk përfaqëson interesa partiake. Ai përfaqëson bindjet e veta dhe përkushtimin për një Kosovë më të mirë. Me një



fjalë, sipas mendimit tim, Fatoni i posedon të gjitha cilësitë e nevojshme për të

qenë një president i suksesshëm i Kosovës. Kërkoj vetëm që emri dhe kualifikimet

e tija të merren në konsideratë gjatë diskutimeve tuaja”, ka theksuar në letrën e tij Walker.



KONJUFCA: LVV I KA EMRAT, GJASAT JANË TË MËDHA PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

PRISHTINË, 26 GUSHT - Numri dy i Qeverisë në detyrë të Kosovës, Glauk Konjufca, tha se partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, i ka emrat për presidentin, por refuzoi që t'i tregonte për mediat, duke argumentuar se do të humbiste kuptimi i procesit të negocimit me Lidhjen Demokratike të Kosovës të udhëhequr nga Lumir Abdixhiku.

Gjatë një prononcimi për media, Konjufca tha se gjasat janë që takimi i radhës mes kreut të LVV-së, njëherësh kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, dhe atij të LDK-së, Abdixhiku, të rezultojë me marrëveshje për presidentin.

Për shkak të moskonsensusit për pasardhësin e Vjosa Osmanit - mandati presidencial së cilës përfundoi në prill - Kosova mbajti zgjedhje të parakohshme në qershor.

LVV-ja dhe LDK-ja, pas dështimit të bisedimeve për bashkëpunim qeveritar, kanë mbajtur një takim ku kanë diskutuar për profilin e presidentit të ardhshëm dhe kanë thënë se synojnë që në takimin e radhës të dalin me emra konkretë. "Lëvizja Vetëvendosje, unë vetëm po



them, që është gati. Kryeministri [në detyrë i Kosovës] Kurti është gati. Emrat i kemi, po nuk mund t'i ndaj këtu me juve", tha Konjufca, duke shtuar se beson që edhe LDK së shpejti do të jetë gati për të dalë me emra konkretë. Ai tha se me informacionet që ka, nuk ka ndonjë ftesë për takim mes Kurtit dhe Abdixhikut, por tha se sipas fjalëve të vetë kreut të LDK-së, një takim i tillë do të duhej të mbahej këtë javë. "Prej kur LDK-ja është deklaruar që janë të

gatshëm për takime dhe që tashmë është paralajmëruar se takimi i radhës do të zhvillohet në formën e propozimit të emrave konkretë lidhur me presidentin e ardhshëm, atëherë e kemi kuptuar menjëherë që ky është një shans i mirë dhe një mundësi e re. Prandaj konsideroj që ekziston një probabilitet goxha i madh që të kemi president dhe një marrëveshje për presidentin", tha Konjufca. Edhe nga LDK-ja një ditë më parë kanë thënë se së shpejti do

të dalin me emra konkretë për presidentin.

Deri më tani, në media kanë qarkulluar disa emra për postin e presidentit. Emri i profesorit Ibrahim Berisha dhe i ish-nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës në vitin 1990, Ilaz Ramaji, u përmendën, por që të dy mohuan përfshirjen në proces. Po ashtu është përmendur edhe emri i ish-presidentit të Kosovës, Fatmir Sejdiu.

Ndërkaq, ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka propozuar emrin e ish-presidentit Hashim Thaçi për president.

Thaçi gjendet në paraburgim në Hagë duke pritur vendimin - që shpallet më 16 shtator - në rastin kundër tij dhe ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli e Jakup Krasniqi dhe ish-deputetit Rexhep Selimi për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Ndërkaq, ish-ambasadori i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, William Walker, ka propozuar që president të bëhet Faton Bislimi, nga radhët e LDK-së.

Ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu,

sipas Kushtetutës mund ta ushtrojë këtë post vetëm për gjashtë muaj - pra deri më 4 tetor. Akti më i lartë juridik në vend nuk ka paraparë e çfarë ndodh nëse përfundon kjo periudhë dhe vendi s'ka president të ri.

LVV-ja kërkon një president konsensual, ndërkaq LDK-ja po ashtu kërkon që kreu i ri i shtetit të mos jetë i lidhur me ndonjë parti politike.

Partia e Kurtit fitoi 53 mandate në zgjedhjet e fundit dhe së bashku me partitë e komuniteteve joshumicë ka votat e mjaftueshme për të konstituuar Kuvendin dhe krijuar Qeverinë e re, pasi për to kërkohej 61 vota në Kuvendin prej 120 deputetësh.

Megjithatë, për zgjedhjen e presidentit nevojitet praninë e 80 deputetëve në Kuvendin me 120 vende që votimi për presidentin e Kosovës të jetë i vlefshëm.

Me një marrëveshje të mundshme me LDK-në për çështjen e presidentit, e cila i fitoi 18 vende, atëherë do të arriheshin të paktën 81 vota, mjaftueshëm për votimin e presidentit të ri, nëse të paktën 80 prej tyre do të qëndronin në sallë.

SHQIPËRIA RIATDHESON PESË SHTETAS NGA SIRIA

TIRANË, 26 GUSHT - Pesë shtetas shqiptarë, dy gra dhe tre fëmijë, janë riatdhesuar nga Siria. Në mesin e të riatdhesuarve është një 79-vjeçare, e cila kishte udhëtuar drejt Sirisë pas vrasjes së djalit, për të marrë nipërit të saj, por mbeti atje për më shumë se një dekadë. "Pas rënies së strukturave territoriale të [grupit ekstremist] Shteti Islamik, e moshuara ka qëndruar në kampin Al-Hol në Siri, ku, në kushte veçanërisht të vështira jetese, ka vijuar të kujdeset për fëmijë të mitur, përfshirë dy fëmijët jetimë që ndodheshin nën kujdesin e saj", njoftoi ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Besfort Lamallari.

Kryeministri shqiptar, Edi Rama, publikoi në rrjetet sociale pamje të mbërritjes së tyre në Aeroportin e Rinasit.

Ai tha se riatdhesimi i pesë shtetasve është një detyrim njerëzor dhe shtetëror, për t'u

garantuar një fillim të ri nën mbrojtjen e institucioneve shqiptare.

Ndërkaq, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme në Tiranë tha se operacioni u krye nga disa institucione shqiptare në bashkëpunim me ato të huaja, veçanërisht siriane, për të mundësuar procedurat dhe transitin e sigurt të shtetasve shqiptarë.

Qeveria shqiptare thekson se do të vijoje punën për kthimin e shtetasve të tjerë shqiptarë nga Siria, nëse krijohen kushtet e nevojshme për një riatdhesim të sigurt.

Deri më tani, sipas autoriteteve shqiptare, janë riatdhesuar 44 shqiptarë, por nuk ka një shifër zyrtare se sa është numri i shqiptarëve që ende vazhdojnë të jenë në Siri.

Operacioni i së mërkurës është pjesë e një procesi që Shqipëria e ka nisur prej disa vitesh.



Në vitin 2020 u riatdhesuan nga kampi Al-Hol pesë gra dhe fëmijë shqiptarë.

Një prej rasteve më të njohura ishte ai i dy të miturve Eva dhe Endri Dumani, motër e vëlla, që u dërguan në Siri nga babai i tyre.

Endri u kthye në Shqipëri në vitin 2020, ndërsa Eva qëndroi

atje deri në shkurt të këtij viti. Ajo u kthye në moshën 21-vjeçare, pas një procesi të gjatë dhe të ndërlikuar. Rasti i saj u bë simbol i situatës së fëmijëve shqiptarë që u dërguan në Siri nga prindërit e tyre dhe që më pas mbetën të bllokuar për vite me radhë në kampe. Ajo u nxor fillimisht nga Siria drejt Turqisë

dhe më pas u kthye në Shqipëri përmes një operacioni të koordinuar sigurie.

Në gusht 2021, gjatë një operacioni u riatdhesuan 19 shtetas shqiptarë, ndërsa një vit më vonë edhe 13 të tjerë.

Në prill 2024, Gjykata e Posaçme në Shqipëri shpalli fajtores nëntë gra të riatdhesuara nga Siria, të akuzuara për pjesëmarrje në organizatë terroriste dhe pjesëmarrje në veprimtari luftarake në një shtet të huaj.

Për vite me radhë, kampet Al-Hol dhe Al-Roj kanë mbajtur mijëra gra dhe fëmijë, shumë prej tyre shtetas të huaj, të cilët kishin lidhje familjare me persona të dyshuar si pjesëtarë ose mbështetës të IS-it.

Edhe Kosova ka riatdhesuar në të kaluar shtetas të saj nga Siria, pasi ata kishin shkuar atje për t'iu bashkuar organizatave terroriste, pasi atje shpërtheu konflikti më 2011.

Rritet kostoja e ndërtimit në vend

PRISHTINË, 26 GUSHT - Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0,9 për qind në tremujorin e dytë për vitin 2026, krahasuar me tremujorin e parë të këtij viti. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) krahasuar tremujorin e dytë 2026 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM2 2025), indeksi i Kostos së Ndërtimit pati rritje për 4,4 për qind.

Sipas një njoftimi për media thuhet se tremujori i dytë 2026 -

Tremujori i parë 2026, 0,9 për qind.

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje për 0,9 për qind në tremujorin e parë (TM1) 026 krahasuar me tremujorin e katërt (TM4) 2025.

Rritje kishte energjia (2.3 për qind), pagat (2.0 për qind), materiale (1.5 për qind) transporti (1.5 për qind), dhe kostot tjera (0.9 për qind) ndërsa Zbritje kishte te makineritë (-0.6 për qind).

Tutje thuhet se në tremujorin e dytë 2026 - tremujori dytë 2025, 4,4 për qind.

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati rritje 4.4 për qind në tremujorin e parë (TM1) 2026 krahasuar me tremujorin e parë (TM1) 2025.

Rritje më të madhe kishte transporti (11.2 për qind), pagat (8.6 për qind), kostot tjera (5.6%) materialet, (4.4 për qind), energjia (2.3 për qind) ndërsa Zbritje kishte te makineritë (-0.9 për qind).



ZKA: SIGURIA NË SHKOLLA KËRKON ANGAZHIM TË PËRBASHKËT TË INSTITUCIONEVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 GUSHT - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit për sigurinë në shkolla, duke vlerësuar mënyrën se si institucionet përgjegjëse kanë përmbushur detyrat për parandalimin, trajtimin, raportimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës dhe çështjeve të tjera të sigurisë në institucionet arsimore. Sipas raportit, vetëm 52 për qind e nxënësve të anketuar i konsiderojnë shkollat e tyre të sigurta, ndërsa 39 për qind i konsiderojnë pjesërisht të sigurta dhe 9 për qind të pasigurta. Auditimi ka përfshirë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Inspektoratin e Arsimit, Policinë e Kosovës, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Qendrat për Punë Sociale dhe shkollat. Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, tha se puna e auditorit publik nuk përfundon me publikimin e raportit, por me

zbatimin e rekomandimeve dhe rezultatet konkrete që sjellin ato. Ajo theksoi se siguria në shkolla nuk lidhet vetëm me infrastrukturën apo reagimin pas incidenteve, por edhe me krijimin e një mjedisi ku fëmijët mbrohen nga dhuna dhe bullizmi, shqetësimet identifikohen me kohë dhe institucionet kanë mekanizma funksionalë për parandalim, raportim dhe reagim. Sipas Spancës, përgjegjësia për sigurinë në shkolla nuk mund t'i atribuohet vetëm një institucioni, por kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet ministrisë, komunave, shkollave, Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë Sociale, prindërve dhe gjithë shoqërisë. Ndërkaq, ministri në detyrë i Arsimit dhe Shkencës, Hajrullah Çeku, tha se gjetjet dhe rekomandimet e raportit janë një udhëzues i rëndësishëm për përmirësimin e punës së institucioneve. Çeku tha se sistemi ligjor dhe institucional për parandalimin dhe trajtimin e dhunës në



shkolla tashmë është ndërtuar, por sfida kryesore mbetet zbatimi dhe rritja e efektshmërisë së masave. Ai u shpreh në pajtim me gjetjet dhe rekomandimet e ZKA-së, duke theksuar se siguria në shkolla është përgjegjësi e përbashkët dhe kërkon angazhimin e të gjithë akterëve. Ndërsa drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka deklaruar se siguria në shkolla është një prej prioritetëve të Policisë së Kosovës dhe se fokusi duhet të

jetë te parandalimi i incidenteve. “Siguria në shkolla është një ndër prioritetet e Policisë së Kosovës dhe një nga shtyllat kryesore me të cilat ndërtohet e ardhmja e sigurt e shoqërisë sonë. Shkolla nuk është vetëm një vend ku fëmijët tanë marrin dije dhe edukim, por është edhe hapësira ku ata formojnë personalitetin, zhvillojnë aftësitë e tyre dhe përgatiten për të ardhmen. Prandaj, krijimi dhe ruajtja e një ambienti të sigurt, të qetë dhe gjithëpërfshirës në institucionet arsimore është

përgjegjësi e përbashkët e të gjitha institucioneve dhe e gjithë shoqërisë sonë. Policia e Kosovës mbetet plotësisht e përkushtuar në përmbushjen e këtij misioni, me qëllim që çdo nxënës të mund të vijoje mësimin pa frikë, çdo mësimdhënës të mund të ushtrijë profesionin e tij në kushte të sigurta dhe prindërit të kenë besimin se fëmijët e tyre janë të mbrojtur gjatë qëndrimit në shkollë dhe në hapësirat përreth saj”, është shprehur Hoxha.

RRJETI I GRAVE: SHTETI DUHET TË PARANDALOJË DHUNËN, JO TË REAGOJË PAS TRAGJEDIVE

PRISHTINË, 26 GUSHT - Vrasja e një gruaje 25-vjeçare shtatzënë në Malishevë ka rikthyer në vëmendje pyetjet për mënyrën se si institucionet në Kosovë po i parandalojnë rastet e dhunës ndaj grave. Gruaja dyshohet se u vra nga bashkëshorti i saj më 24 gusht. Nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) thonë për Radion Evropa e Lirë se ky rast po vë në pikëpyetje efektivitetin e mekanizmave shtetërorë që janë ngritur me synimin që të mbrojnë viktimat e dhunës. Që nga viti 2010 e deri në gusht të vitit 2026, Policia e Kosovës ka regjistruar 62 gra si viktima të vrasjeve brenda familjes. Pas rastit të fundit, zëvendëskryeministrja dhe ministrja në detyrë e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka zhvilluar takim me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Prokurorisë, Gjykatës dhe Qendrës për Punë Sociale, për të shqyrtuar funksionimin e mekanizmave institucionale dhe masat që duhet të ndërmerren për parandalimin e rasteve të tilla. “Parandalimi kërkon vigjilencë, përgjegjësi dhe bashkëpunim të plotë mes institucioneve. Secili duhet të jetë në nivelin e detyrës,



të veprojnë me kohë dhe të mos lejojnë asnjë hallkë e sistemit të dështojë”, ka thënë Gërvalla thuhet në njoftimin më shkrim nga kjo ministri. Ndërkaq, RrGK-ja ka kërkuar vazhdimisht që shteti të investojë në parandalimin e dhunës dhe jo vetëm të reagojë pasi një grua të jetë sulmuar apo vvarë. “Gratë po vriten dhe shteti ende nuk po arrin t'i mbrojë ato në mënyrë efektive. Për Rrjetin, këto nuk janë raste të izoluar apo tragjedi individuale. Ato janë tregues të

dështimeve sistemike në parandalimin dhe trajtimin e dhunës ndaj grave”, thuhet në përgjigjen e RrGK-së për Radion Evropa e Lirë. Ky rrjet rikthen në vëmendje edhe rastin e Hamide Magashit, e cila ishte shtatzënë kur u vra nga bashkëshorti i saj, katër vjet më parë, në oborrin e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe kishte urdhër mbrojtës aktiv, por nuk u mbrojt. Rasti i saj, sipas RrGK-së, dëshmon se ekzistenca e

mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e grave nuk është e mjaftueshme nëse ata nuk zbatohen në mënyrë efektive. “Kjo ngre një pyetje shumë serioze: nëse një grua që ka kërkuar mbrojtje nga shteti dhe ka një urdhër mbrojtës ende mund të vritet, atëherë ku po dështon sistemi?”, thuhet në përgjigjen e RrGK-së. Rrjeti kërkon zbatim efektiv të urdhrave mbrojtës, vlerësim të detajuar të rrezikut, monitorim të kryesve të dhunës dhe

bashkëpunim më të mirë ndërmjet policisë, prokurorisë, gjykatave dhe shërbimeve sociale. Po ashtu, kërkon përgjegjësi institucionale në rastet kur këta mekanizma dështojnë. Ndërkohë, Gërvalla, e cila është edhe koordinatore Kombëtare kundër Dhunës në Familje, Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës me Bazë Gjinore, ka ritheksuar se institucionet do të kenë zero tolerancë ndaj dhunës, duke e cilësuar mbrojtjen e viktimave si përgjegjësi të drejtpërdrejtë të shtetit “Mbrojtja e jetës dhe sigurisë së çdo gruaje dhe çdo qytetari është përgjegjësi e padiskutueshme institucionale”, ka thënë ajo. Më 2020, Kosova e ka miratuar Konventën e Stambollit të hartuar nga Këshilli i Evropës, duke e bërë pjesë të Kushtetutës së vendit. Ky instrument obligues detyron shtetet që ta luftojnë dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Në bazë të konventës, parashihet që shteti të mbrojë viktimat duke u ofruar strehimore, të ndjekë penalisht dhunën ndaj grave, të gjitha institucionet shtetërore të bashkëpunojnë dhe të ketë mekanizma që monitorojnë nëse konventa zbatohet.

Rama: Çështjes së pastrimit në kryeqytet po i japim zgjidhje përfundimisht

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryetari i Kryeqytetit, Përparim Rama, bashkë me nënkryetaren Besianë Musmurati dhe drejtorin e Shërbimeve

Publike, Leutrim Retkoceri, ishin në Ndërmarrjen Publike “Pastrimi”, për të diskutuar drejtpërdrejt me drejtuesit dhe punëtorët për gjendjen

aktuale dhe zgjidhjet që na duhen. Ata u zotuan që bashkë do të ndërmarrin hapat e mëtejme për ta përmirësuar menjëherë

situatën, por edhe për të ndërtuar një zgjidhje të qëndrueshme për pastrimin dhe menaxhimin e mbeturinave në Kryeqytet.



VENDOSËT GURTHEMELI PËR AUTOSTRADËN SHKUP - BLLACË

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka marrë pjesë në fillimin e punimeve në autostradën Shkup - Bllacë, në Maqedoninë e Veriut. Të pranishëm ishin edhe kryeministrin i Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski dhe zëvendëskryeministri Izet Mexhiti.

Kurti ka thënë se autostrada Shkup-Bllacë me pesë tunele, tetë ura e katër galeri, do ta forcojë shumë më tepër lidhjen infrastrukturore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ai ka theksuar se rëndësia e saj shkon përtej infrastrukturës. “Përveç se do të shkurtohet distanca, do të lehtësohet lëvizja dhe do të krijohen mundësi të reja bashkëpunimi për qytetarët dhe ekonominë e dy vendeve tona. Ne jemi dy shtete që kanë qarkullim të lartë të qytetarëve në të dyja anët e kufirit. Familjet, studentët, punëtorët, profesionistët dhe bizneset tona lëvizin çdo ditë mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Vetëm përmes pikës doganore në Han të Elezit kalojnë rreth 54 mijë maune në vit, apo rreth 150 maune në ditë. Prandaj, çdo kilometër i ri rrugë që na afron është investim në jetën e qytetarëve tanë dhe në zhvillimin ekonomik të të dyja vendeve”, është shprehur Kurti, duke shtuar se kjo autostradë do ta bëjë këtë qarkullim më të shpejtë, më të sigurt e më efikas. “Njëkohësisht, do t’u japë bizneseve tona mundësi më të mëdha për t’i lëvizur mallrat, për t’i zgjeruar tregjet dhe për të krijuar partneritete të reja. Në Kosovë po punojmë që lidhja infrastrukturore me vendet fqinje dhe me korridoret evropiane të rritet edhe më shumë dhe ky projekt i sotëm është dëshmi konkrete e këtij vizioni. Kjo autostradë është pjesë e rrjetit evropian TEN-T dhe e lidhjes

strategjike që përmes Kosovës e afron Shkupin me Prishtinën dhe më tej me rrjetet dhe tregjet evropiane”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka shtuar se këtij vizioni i përket edhe Linja 10 hekurudhore, e cila e lidhë Kosovën me Maqedoninë e Veriut, e gjithashtu, këtij vizioni i përket edhe projekti Prizren-Tetovë përmes tunelit, të cilin po e realizojmë gjithashtu bashkërisht. “Këto projekte janë ura gjigande të zhvillimit, të bashkëpunimit dhe të afrimit mes qytetarëve tanë. Prandaj, është shumë domethënëse që sot po nisë realizimi i këtij projekti, që është premtuar për shumë vite dhe që ka rëndësi kaq të madhe për të dyja vendet tona dhe qytetarët tanë”, ka thënë Kurti.

Me këtë rast, ai ka falënderuar Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të gjithë kontribuesit që ky projekt të nisë së zbatuari. “Një falënderim i veçantë shkon edhe për koalicionin e partive shqiptare, për kontributin e tyre në punë të mira e të mbara në shërbim të qytetarëve dhe të bashkëpunimit mes dy vendeve tona”, është shprehur Kurti.

Zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Izet Mexhiti Izet Mexhiti, ka thënë se kjo është rruga që lidh Shkupin



me Prishtinën. “Dy kryeqendra, dy ekonomi, mijëra familje, biznese e njerëz që çdo ditë lëvizin mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Sot nuk flasim për atë që do të bëhet. Sot e nisëm! Dhe ky është ndryshimi që qytetarët duhet ta shohin dhe ta ndjejnë, me projekte të mëdha që nisen, investime që marrin formë dhe një përfaqësim politik që fuqinë e vet e shndërron në rezultate e punë. Sepse pesha në Qeveri nuk matet me fjalë. Matet me atë që arrin ta bësh për njerëzit e tu. Autostrada Shkup - Bllacë është një prej rezultateve që e tregojnë më së miri këtë peshë politike. Sot vendosëm gurthemelin. Nesër, në këtë rrugë do të udhëtojnë gjenerata të tëra”, ka thënë ai.



Çmimet e importit në Kosovë rriten 1.4% në TM2, por bien 2.6% në bazë vjetore

PRISHTINË, 26 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2026.

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pati rritje për 1,4 % në TM2 2026 krahasuar me TM1 2026. Ndërkaq, krahasuar me TM2 2026, Indeksi pati rënie prej 2,6%.

Tremujori i dytë 2026 / Tremujori i parë 2026 1,4 %

Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (5,5%), plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (4,8%), produktet minerale (4,7%), tekstili dhe artikujt e tekstilit (3,6%), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (1,6%), druri dhe artikujt e tij (1,6%), etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit te: instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinal, muzikorë dhe mekanizmat e orës (-3,7 %), letra dhe artikujt e saj (-1,7 %), pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (-0,8 %), artikujt e ndryshëm të prodhuar (-0,8 %) dhe lëkura dhe artikujt e saj (-0,6 %).

Tremujori i dytë 2026 - Tremujori i dytë 2025 2,6 %

Çmimet e Importit në Kosovë patën rënie në një mesatare prej 2,6 % ndërmjet (TM2) 2026 dhe (TM2) 2025.

Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet minerale (12,7 %), vajrat ushqyese (7,7 %), këpucët (5,5 %), produktet e industrive kimike (4,1 %), druri dhe artikujt e tij (3,2 %), shtazët e gjalla; produktet e shtazëve (3,0 %), lëkura dhe artikujt e saj (2,6 %), artikujt ushqimor të përgatitur, pijet dhe duhani (2,3 %), etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit: produktet bimore (-5,7 %), instrumentet optike, fotografik, matës, medicinal dhe muzikorë dhe mekanizmat e orës (-3,8 %), metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-1,3 %), letrat dhe artikujt e saj (-1,1 %) dhe tekstili dhe artikujt e tekstilit (-0,2 %).

KUSARI-LILA PRITI NË TAKIM DELEGACIONIN E BIZNESEVE TË HUAJA, NË FOKUS MUNDËSITË PËR INVESTIME NË KOSOVË

PRISHTINË, 26 GUSHT - Interesi i kompanive të huaja për mundësitë që ofron Kosova për investime po shënon rritje, duke përfshirë kompani nga vendet e rajonit, Lindja e Mesme dhe Azia.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka prituri në ministri një delegacion të përbërë nga biznese nga Libani, Turqia, Rumania dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

Në takimin e përbashkët morën pjesë përfaqësues të kompanive nga sektorë të ndryshëm, në kuadër të një delegacioni të organizuar nga “Strategic Group”, i drejtuar nga Arianit Shehu.

Kompanitë pjesëmarrëse veprojnë në fusha të ndryshme, përfshirë energjinë, bujqësinë, turizmin, montimin e konstruksioneve metalike, teknologjinë, inxhinierinë dhe sektorë të tjerë.



Gjatë takimit u diskutua për transformimin industrial që synohet të realizohet në Kosovë dhe për mundësitë konkrete që vendi ofron për investitorët e huaj. Në këtë drejtim, u prezantuan edhe investimet që MINTI po planifikon në zhvillimin e parqeve industriale në disa komuna të Kosovës, me synim rritjen e prodhimit vendor dhe krijimin e infrastrukturës së për-

shtatshme për zhvillimin e bizneseve dhe tërheqjen e investimeve të reja. Kosova po shihet gjithnjë e më shumë si një destinacion me potencial për investime, ndër të tjera për shkak të përafrimit të politikave me standardet e Bashkimit Evropian, popullsisë së re, fuqisë punëtore të kualifikuar dhe politikave fiskale atraktive.

Në takim u vlerësua se rritja e interesimit nga kompanitë ndërkombëtare krijon mundësi të reja për zgjerimin e investimeve, zhvillimin e sektorëve të rinj dhe krijimin e vendeve të punës. Institucionet e Republikës së Kosovës mbeten të angazhuara për forcimin e mëtejshëm të klimës së investimeve, rritjen e sigurisë dhe besimit për investitorët dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për kompanitë vendore dhe të huaja që synojnë të zhvillojnë aktivitetin e tyre në Kosovë.

NIS RËNIA E DIELLORËVE NË EUROPE, FALIMENTON CENTRALI MË I MADH I PORTUGALISË



Kompania britanike Welink Energy Portugal 2 UK, e cila zotëron Solara4 - termocentralin më të madh diellor në vend - ka hyrë në procedurat e falimentimit, sipas një raporti të publikuar këtë muaj nga konsulenca BDO dhe të cituar nga Expresso.

Çështja ka të bëjë me një projekt në shkallë të gjerë në rajonin e Algarve me 219 MW kapacitet të instaluar diellor, sipas faqes së internetit të Welink Group.

E vendosur në Alcoutim, Solara4 ka qenë në funksion që nga inaugurimi i saj në vitin 2021, por është përballur me një sërë pengesash.

Raporti i BDO-së, i cituar që atëherë nga disa media kombëtare, thotë se termocentrali "ka kaluar nëpër një kombinim sfidash operacionale dhe të tregut që kanë ndikuar negativisht në performancën dhe gjenerimin e fluksit të parave të gatshme".

Dokumenti shton se "prodhimi i energjisë elektrike ka qenë vazhdimisht nën parashikimet fillestare. Në të njëjtën kohë, tregu iberik i energjisë ka parë një rritje të ndjeshme të kapacitetit të gjenerimit diellor".

"Kjo rritje e furnizimit ka ulur çmimet me shumicë, të cilat herë pas here bien në zero ose në

territor negativ."

Si rezultat i këtyre faktorëve të kombinuar, "të ardhurat kanë qenë më të ulëta se sa pritej". Expresso raporton gjithashtu se mosmarrëveshjet midis kompanisë britanike dhe kontraktorit të saj, China Triumph International Engineering, një degë e një konglomerati industrial shtetëror kinez, së bashku me zjarret dhe problemet e tjera teknike, kanë penguar operacionet e Solara4.

Pavarësisht kësaj trajektoreje të trazuar, Jurnal Económico raportoi në vitin 2024 se Welink kishte vendosur të "hibridizonte" termocentralin diellor përmes një

investimi prej 400 milionë eurosh, duke rritur kapacitetin diellor ndërsa shtonte energjinë e erës dhe ruajtjen e baterive.

Plani fillestar parashikonte prodhim të pandërprerë të energjisë elektrike përmes 50 MW të tjera të kapacitetit diellor, 264 MW të energjisë së erës në 40 turbina dhe një sistemi të ruajtjes së energjisë në bateri (BESS) prej 100 MW, duke e çuar kapacitetin e instaluar në "më shumë se 600 MW... pas përfundimit", sipas faqes së internetit të Welink Group.

Megjithatë, komiteti i vlerësimit i udhëhequr nga Agjencia Portugeze e Mjedisit (APA) i dha

projektit të zgjeruar një mendim të pafavorshëm, duke konstatuar se ai nuk do të ishte "i pajtueshëm me ruajtjen e vlerave mjedisore të pranishme në zonën e prekur". Welink më vonë e rishikoi planin, duke ulur numrin e turbinave me erë të planifikuara në pak më shumë se gjysmën, dhe e vendosi atë në konsultim publik. APA ende nuk ka marrë një vendim përfundimtar.

E gjithë kjo ndodhi pasi Solara4 ishte tashmë pranë shitjes. Brenda procesit aktual të falimentimit, përparësia është përsëri gjetja e investitorëve të rinj të gatshëm të blejnë asetin./Expresso

Britania e Madhe përgatitet për një sulm të mundshëm rus

Furnizime me ujë dhe ushqime të konservuara. Mbretëria e Bashkuar po përgatitet për një sulm "të mundshëm" rus me një apel për qytetarët. Sipas Financial Times, kryeministri Andy Burnham po zhvillon një fushatë informuese, që synon forcimin e vendit, jo vetëm përballë emergjencave klimatike, por edhe përballë një sulmi të mundshëm fizik ose kibernetik nga Moska.

Mbretëria e Bashkuar do t'i jap Ukrainës autorizimin për të ndërtuar në mënyrë të pavarur raketa me rreze të gjatë veprimi të afta për të goditur territorin rus. Ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov e cilësoi si një pjesëmarrje në

luftë.

Pyetja tani, sipas shërbimeve sekrete, është kur do të ketë hakmarrje ruse, veçanërisht pas ndërhyrjes së Burnham në 35-vjetorin e pavarësisë së Ukrainës.

Me sa duket, Vladimir Putin besonte se kryeministri i ri do të ishte më i butë me Rusinë sesa paraardhësi i tij, Keir Starmer: Burnham në vend të kësaj rriti angazhimin e tij për të mbështetur Ukrainën dhe akuzoi Rusinë se kishte "ndezur zjarrin" duke filluar konfliktin.

Shërbimet sekrete kanë mësuar se "Rusia po përpaket të shkelë infrastrukturën britanike çdo ditë".

Qeveria po përditëson kështu



"librin e saj të luftës", një manual për mbrojtjen e vendit në rast sulmi. Javën e kaluar, doli se hakerat kishin arritur të

depërtonin në menaxhimin e një termocentrali në Mbretërinë e Bashkuar, një operacion që nxori në pah

cenueshmërinë e sistemit energjetik të vendit.

Dieter Helm, një profesor ekonomie në Universitetin e Oksfordit, i tha Financial Times se ka disa objektiva të lehtë dhe për këtë arsye me rrezik të lartë në Britani, nga parqet eolike në brigjet e Aberdeenit, Skoci, deri te tubacioni i gazit nënujor që lidh Norvegjinë dhe Anglinë. Një zëdhënës i Downing Street theksoi se siguria kombëtare është një përparësi për çdo qeveri dhe se Londra dëshiron t'i edukojë qytetarët rreth masave praktike që mund të ndërmarin për t'u përgatitur dhe për t'u mbrojtur nga kërcënime të ndryshme. (Corriere della Sera)

KROACIA E SHQETËSUAR: SERBIA PO ARMATOSET, PERËNDIMI DUHET TA DIJË



Evropa duhet të forcojë sigurinë e saj dhe shtyllën evropiane të NATO-s, ndërsa rendi ndërkombëtar po ndryshon, deklaroi të martën kryetari i Parlamentit kroat, Gordan Jandrokovic, në konferencën e ambasadorëve, konsujve dhe atasheve ushtarakë kroatë. Jandrokovic paralajmëroi në veçanti për rritjen e armatimit

të Serbisë, duke theksuar se Beogradi nuk po blen vetëm armë mbrojtëse, por edhe armë me natyrë ofensive. “Serbia po armatohet jo vetëm me armë mbrojtëse, por edhe me armë ofensive dhe sulmuese. Dhe ne duhet t’ua themi këtë aleatëve tanë perëndimorë. Nuk duhet të shmangemi nga kjo“, tha

Jandrokoviç. Ai tha se Kroacia do të vazhdojë të mbështesë multilateralizmin, të drejtën ndërkombëtare dhe rendin ndërkombëtar, por duhet të jetë e vetëdijshme për ndryshimet në botë dhe të ketë një përgjigje ndaj tyre. Sipas Jandrokovic, është e rëndësishme që Evropa të forcojë shtyllën e saj brenda

NATO-s, pasi për dekada ka jetuar me besimin se Shtetet e Bashkuara gjithmonë e mbështesin atë. Ai vlerësoi se kjo ka bërë që Evropa dhe disa nga shtetet e saj të neglizhojnë sigurinë e tyre. Kryetari i Parlamentit kroat u ndal edhe te situata në rajon, duke thënë se Kroacia duhet t’u

shpjegojë partnerëve të saj perëndimorë zhvillimet në Ballkanin Perëndimor. Ai paralajmëroi se elitat e reja politike në Perëndim shpesh nuk dinë mjaftueshëm për ish-Jugosllavinë dhe nuk kanë kujtesën e politikave të Slobodan Millosheviqit dhe shpërbërjes së ish-shtetit jugosllav.

RUSIA PËRGATIT ‘ÇERNOBILIN FLUTURUES’?

Rusia po shfaq shenja se mund të jetë duke u përgatitur për një tjetër test të raketës së saj eksperimentale me energji bërthamore, Burevestnik, një armë që në Perëndim është pagëzuar me emrin shqetësues “Çernobili Fluturues”. Lëvizje të pazakonta të aviacionit rus janë regjistruar ditët e fundit në Novaya Zemlya, arkipelagun e largët në Arktik ku ndodhet poligoni Pankovo, i ndërtuar posaçërisht për programin Burevestnik. Imazhet satelitore tregojnë se dy avionët rusë Il-976 SKIP kanë mbërritur në bazën ajrore Rogachevo. Këta avionë përdoren për gjurmimin e raketave, mbledhjen e telemetrisë dhe monitorimin e të dhënave, përfshirë rrezatimin. Në bazë është evidentuar gjithashtu një avion radar A-50U, katër avionë transporti An-26, një An-74D dhe disa




helikopterë. Në zonën detare përreth Novaya Zemlya janë pozicionuar edhe anije që besohet se përdoren për

monitorimin e fluturimeve eksperimentale dhe operacionet e rikuperimit të raketave. Një pjesë e hapësirës



ajrore në Detin Barents është gjithashtu e kufizuar për fluturimet. Megjithatë, analistët paralajmërojnë se

këto lëvizje mund të lidhen edhe me prova paraprake dhe nuk provojnë se lëshimi është i menjëhershëm. Burevestnik, i njohur nga NATO si SSC-X-9 Skyfall, është një raketë lundruese e pajisur me një reaktor të vogël bërthamor. Pikërisht sistemi i saj i shtytjes teorikisht i jep një rreze jashtëzakonisht të madhe veprimi dhe mundësinë për të ndjekur trajektore të paparashikueshme për të shmangur sistemet e mbrojtjes ajrore. Por teknologjia ka ngritur shqetësime serioze për sigurinë. Ekspertët perëndimorë kanë paralajmëruar se sistemi i shtytjes mund të shkaktojë çlirime radioaktive, ndërsa një aksident gjatë testimit mund të sjellë ndotje në zonën ku raketa rrëzohet. Kjo është edhe arsyeja pse arma është etiketuar “Çernobili Fluturues”.



Ballkani “blindon” portën, transferon Gentian Selmanin

SUHAREKË, 26 GUSHT - Ballkani ka zyrtarizuar transferimin e portierit shqiptar Gentian Selmani, i cili i bashkohet skuadrës nga Suhareka pas një sezoni të suksesshëm te Teuta e Durrësit. Selmani, i

lindur më 9 mars 1998 në Krujë, është formuar në futbollin shqiptar dhe gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe jashtë vendit. Ai ka qenë pjesë e Menemen FK dhe Boluspor në Turqi, ndërsa ka

regjistruar paraqitje edhe me Kombëtaren e Shqipërisë. Në sezonin 2025/26, portieri ishte një nga lojtarët kryesorë të Teutës, duke regjistruar 40 paraqitje në të gjitha garat. Me këtë transferim, Ballkani

forcon repartin e portës me një futbollist me përvojë në futbollin vendor dhe ndërkombëtar. Selmani pritet të jetë pjesë e skuadrës si në garat vendore, ashtu edhe në ato evropiane.



KOSOVA HUMB NGA ITALIA DHE ELIMINOHET NGA PADELI NË LOJËRAT MESDHETARE



TARANTO, 26 GUSHT - Ka përfunduar gara e Kosovës në padel në Lojërat Mesdhetare “Taranto 2026”. Ekipi miks i Kosovës pësoi 2:0 në sete ndaj ekipit të Italisë. Italianët ishin dominantë, duke i fituar të dyja setet me rezultat 6:0. Ndeshja i takoi fazës çerekfinale. Për Kosovën u paraqitën

Donika Bashota dhe Lavdrim Krasniqi. Në padel, Kosova ka pasur rezultate solide. Ekipi i parë i meshkujve dhe ekipi miks shënuan nga një fitore dhe u ndalën në ndeshjet e dyta. Ndërkohë, dy ekipet e femrave dhe ekipi i dytë i meshkujve u ndalën në përballjet e para.

XHUDISTËT E KOSOVËS, GATI PËR MEDALJE NË ‘TARANTO 2026’

TARANTO, 26 GUSHT - Gjatë kësaj jave, sportistët e Kosovës po garojnë në Lojërat Mesdhetare “Taranto 2026”, duke përfaqësuar vendin tonë në disiplina të ndryshme sportive. Tani, radha i vjen sportit që i ka sjellë Kosovës sukseset më të mëdha në arenën ndërkombëtare, xhudos.

Më 28 dhe 29 gusht, xhudistët tanë do të garojnë për medalje në Lojërat Mesdhetare në Taranto të Italisë. Kosovën në xhudo do ta përfaqësojnë: Erza Muminoviq (-48 kg), Fatjona Kasapi (-52 kg), Flaka Loxha (-57 kg), Laura Fazliu (-63 kg), Akil Gjakova (-73 kg), Dardan Cena (-81 kg) dhe Shpati Zekaj (-100 kg).

Në këtë garë do të marrin pjesë 162 garues, 84 meshkuj dhe 78 femra, nga 22 shtete pjesëmarrëse. Ekipi i Kosovës



do të udhëhiqet nga kryemjeshtri Driton Kuka dhe trajnerja Majlinda Kelmendi, ndërsa me delegacionin ka udhëtuar edhe kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka.

Gjithashtu, pjesë e këtij udhëtimi janë edhe Zymer Zeka si partner sparing, Fatos Tabaku dhe Distria Krasniqi, në kuadër të përfaqësimit të tyre në Bordin e Komitetit Olimpik të Kosovës.

TALENTI BOUADDI I BASHKOHET CITYT PËR 100 MILIONË EURO

MANCHESTER, 26 GUSHT - Supertalenti 18-vjeçar, Ayyoub Bouaddi, është lojtari i ri i Manchester Cityt. Gjiganti anglez të mërkurën ka prezantuar transferimin e mesfushorit të Kombëtares së Marokut. Bouaddi deri më tani ka luajtur për Lille në Francë, ndërsa, sipas raportimeve, është transferuar për plot 100 milionë euro. Me skuadrën angleze, Bouaddi ka firmosur kontratë



pesëvjeçare, ndërsa me fanelën e Lille ka regjistruar 96 paraqitje në të gjitha garat. Për Marokun, Bouaddi ka debutuar në moshën 16-vjeçare dhe ka zhvilluar tetë ndeshje. “Është ditë e veçantë për mua dhe familjen time. Manchester City është klubi më i mirë në botë. Është ëndërr të jem këtu dhe ta quaj veten lojtar i Cityt”, ka deklaruar Bouaddi në prezantimin e tij.

Bruno Fernandes shpallet lojtari më i mirë në Angli

LONDËR, 26 GUSHT - Bruno Fernandes është shpallur Lojtari i Vitit nga Shoqata e Futbollistëve Profesionistë (PFA) për sezonin 2025/26, pas një sezoni të jashtëzakonshëm me Manchester United.

Çmimi i është dorëzuar kapitenit portugez gjatë ceremonisë vjetore të PFA-së, ndërsa fituesi u përcaktua nga votat e vetë futbollistëve. Fernandes ka triumfuar përballë pesë finalistëve të tjerë: Erling Haaland, Rayan

Cherki, Gabriel Magalhaes, David Raya dhe Declan Rice. Ky është çmimi i tretë i madh individual për Fernandesin gjatë sezonit 2025/26. Ai më herët kishte fituar edhe Lojtarin e Vitit në Premier League dhe çmimin e

Shoqatës së Shkrimtarëve të Futbollit (FWA). Me këtë sukses, Fernandes bëhet fitues i të tre çmimeve kryesore individuale për futbollistët në Angli, duke vulosur një sezon të jashtëzakonshëm personal.





Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 13 par.5 të Rregullorës 07-2024 nr.6697 dt.05.11.2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM Pastrimi Sh.A, Rregullorës Nr.01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, nenit 27 të Statutit të KRM "Pastrimi" Sh.A, Kryeshefi Ekzekutiv merr këtë:

VENDIM

1. **VAZHDOHET AFATI I KONKURSIT** të Publikuar me datë 21.08.2026 nr.prot.06/03/6416, për pranimin e kandidatëve në pozitat vijuese:
 - 1.1 “Punëtor Sezonal i Bartjes“ NJO – Prishtinë (15) pesëmbëdhjetë pozita”
2. Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet edhe për 3 (tre) ditë duke filluar nga data 25.08.2026 deri më date 27.08.2026
3. Kriteret në Konkurs mbeten të njëjta si dhe aplikantët të cilët kanë aplikuar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A**

Na osnovu člana 8. Zakona br. 03/I-212 o radu, člana 13. stav 5. Uredbe 07-2024 br. 6697 od 05.11.2024. o Ugovoru o radu u KRM „Pastrimi“ Sh.A., Uredbe br. 01/2024 o Organizaciji i Sistematizaciji i Evidenciji poslova u KRM „Pastrimi“ Sh.A., člana 27. Statuta KRM „Pastrimi“ Sh.A., Izvršni direktor donosi:

ODLUKU

1. **PRODUŽAVA SE ROK KONKURSA** objavljenog dana 21.08.2026. godine, br. prot. 06/03/6416, za prijem kandidata na sledeće radno mesto:
- 1.1 „Sezonski radnik na poslovima utovara“ – NVO – Priština (15) petnaest izvršilaca.
2. Rok za podnošenje prijave produžava se za još 3 (tri) dana, počev od 25.08.2026. godine do 27.08.2026. godine.
3. Uslovi konkursa ostaju isti, a kandidati koji su se prijavili na ovaj konkurs nisu u obavezi da se ponovo prijavljuju.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime
drejtë përqaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook


www.facebook.com/gjeipuneshpejter

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Milazim Dana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Shaban Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Driton Bucaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri ” Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi ” Prizren.
- Trim Reznici shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilismani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.
- Atdhe Gashi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e diplomës të shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.
- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

